

URDHËR
Nr. 158, datë 21.4.2015

**PËR LICENCIMIN E AGJENCISË SË ADMINISTRIMIT KOLEKTIV PËR TË DREJTAT
E AUTORIT "ALBAUTOR"**

Duke marrë parasysh propozimin nr. 374, datë 31.3.2015 të Zyrës Shqiptare për të Drejtën e Autorit, për licencimin e agjencisë së administrimit kolektiv të së drejtës së autorit "ALBAUTOR"

KONSTATOVA SE:

Në përmbushje të detyrimeve që burojnë nga ligji nr. 9380, datë 28.4.2005 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të", të ndryshuar, është kompetencë e ministrit të Kulturës dhënia e licencës kësaj agjencie në fushën e menaxhimit kolektiv të të drejtave të autorëve të veprave artistike dhe letrare.

Për sa më sipër, në mbështetje të pikës 4 të nenit 102, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, dhe të pikës 1 të nenit 108, pikës 1 dhe 3 të nenit 109, të ligjit nr. 9380, datë 28.4.2005 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Licencimin e Agjencisë së Administrimit Kolektiv për të Drejtat e Autorit "ALBAUTOR".
 2. Afati i licencës është 3 (tre) vjet nga hyrja në fuqi e këtij urdhri.
- Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I KULTURËS
Mirela Kumbaro(Furxhi)